

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 2 (dy) vende pune për personel akademik pranë Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës si më poshtë:

A. 1 (një) vend pune për personel akademik efektiv të kategorisë “Lektor” në lëndët “Kompozimi, Analiza e Formës dhe Hapësirës”, në programin e studimit MSHA-Profilin Arkitekt dhe Bachelor në Arkitekturë Interieri dhe Dizajn.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati

- Të ketë diplomë të ciklit të dytë në Arkitekturë
- Të ketë gradën shkencor “Doktor”.
- Kandidati për personel akademik me kohë të plotë duhet të ketë një mesatare të përgjithshme të ponderuar të studimeve të larta të dy cikleve apo të ciklit të integruar, jo më pak se 80/100 (statuti i UPT-së, neni 42 pika b).
- Të ketë të paktën 5 vite eksperiencë profesionale dhe akademike.
- Të zotërojë të paktën një nga gjuhët: anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, spanjisht.

B. 1 (një) vend pune për personel akademik efektiv të kategorisë “Asistent-Lektor” në lëndët “Grafikë Arkitektonike”, në programin e studimit MSHA-Profilin Arkitekt dhe Bachelor në Arkitekturë Interieri dhe Dizajn.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati

1. Të ketë diplomë të ciklit të dytë në Arkitekturë.
2. Kandidati për personel akademik me kohë të plotë duhet të ketë një mesatare të përgjithshme të ponderuar të studimeve të larta të dy cikleve apo të ciklit të integruar, jo më pak se 80/100 (statuti i UPT-së, neni 42 pika b).
3. Të ketë të paktën 3 vite eksperiencë profesionale dhe akademike.
4. Të zotërojë të paktën një nga gjuhët: anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, spanjisht.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi/interesi ku të përfshijë:
 - *Pozicionin e kërkuar*
 - *Arsyet e kandidimit*
 - *Çfarë i ofron kandidati institucionit/ departamentit/ grup-lëndëve*

- *Përmbledhje mbi qasjen teorike/ metodologjike të kandidatit për lëndët ku do të angazhohet (500 fjalë).*
- 2. Cv e plotë, akademike dhe profesionale.
- 3. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS).
- 4. Dëshminë e gjuhës së huaj e noterizuar.
- 5. Letër reference nga dy persona me gradë ose titull akademik (referenca të paraqitet në zarf të mbyllur të firmosur nga referenti).
- 6. Fotokopje e pasaportës ose kartës së identitetit;
- 7. *Portofolio* punësh të lidhura me disiplinat e vendit vakant.
- 8. Letër reference nga punëdhënësi i fundit.
- 9. Kopje të noterizuar të gradës shkencor si dhe një përmbledhje të tezës së kryer. Gradat e fituara jashtë vendit, duhet të shoqërohen me dokumentin e njohjes nga MAS.
- 10. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
- 11. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
- 12. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

Nëse ka, kandidati mund të paraqesë edhe:

- 13. Deri në dy publikime të plota të përzgjedhura (artikull, ese, punime shkencore etj)
- 14. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **12.09.2025** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.

II. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vend pune për personel akademik pranë Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës si më poshtë:

A. 1 (një) vend pune për personel akademik të kategorisë “Asistent Lektor” në Departamentin e Restaurimit dhe Teknologjisë së Arkitekturës.

Kriteret e punësimit në vendin vakant për personel akademik me kohë të plotë, pranë Departamentit të Restaurimit dhe Teknologjisë së Arkitekturës, në pozicionin asistent lektor në disiplinat e fushës së Teknologjisë së Arkitekturës si më poshtë vijon:

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet universitare, në Programet e Integruara të Studimit të Ciklit të Dytë, ose në Programet e Studimit të Ciklit të Parë dhe të Dytë, Master Shkencor (ekuivalent me të) në Arkitekturë, me një notë mesatare të përgjithshme të ponderuar të studimeve të larta të të dy cikleve apo të ciklit të integruar, së paku 80/100.
2. Kandidati duhet të ketë një notë mesatare mbi 8, në një grup-lëndët e Teknologjisë së Arkitekturës.
3. Kandidati duhet të ketë eksperiencë, së paku prej 3 (tre) vitesh, në mësimdhënie.
4. Preferohen kandidatët që kanë kryer kurse, kualifikimi apo kanë bërë publikime brenda ose jashtë vendit, në fushën e Teknologjisë së Arkitekturës.
5. Kandidati duhet të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj, të mbrojtur dhe të vërtetuar me dëshmi.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimi (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. *Portofolio* e punëve dhe kopje të botimeve/publikimeve;
7. Dy letra reference nga persona me grada, tituj shkencorë apo me eksperiencë në mësimdhënie në arsimin e lartë;
8. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
9. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
10. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
11. Dëshminë e gjuhës së huaj e noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **12.09.2025** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.

III. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik pranë Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës si më poshtë:

A. 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik në pozicionin “Sekretare mësimore” në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës duhet të plotësoj kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të ketë përfunduar arsimin e lartë dhe të disponojë diplomë të nivelit të dytë “Master i Shkencave”.
2. Të zotërojë, me dëshmi njohuri të një gjuhe të huaj perëndimore – preferohet gjuha angleze.
3. Të ketë njohuri të mira të programeve bazë kompjuterike.
4. Të demonstrojë aftësi të mira komunikuese dhe organizative në përmbushjen e detyrave të punës.
5. Të mos jetë larguar nga puna e mëparshme për arsye disiplinore.
6. Të ketë eksperiencë pune në fusha të ngjashme.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

12. Letër motivimi;
13. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
14. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
15. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
16. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
17. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
18. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
19. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
20. Dëshminë e gjuhës së huaj e noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **10.09.2025** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.